



REPUBLIKA E KOSOVËS-REPUBLIKA KOSOVA-REPUBLIC OF KOSOVO
KËSHILLI I PAVARUR MBIKËQYRËS PËR SHËRBIMIN CIVIL TË KOSOVËS
NEZAVISNI NADZORNI ODBOR CIVILNE SLUŽBEKOSOVA
INDEPENDENT OVERSIGHT BOARD CIVIL SERVICE OF KOSOVO

Pranuar / Dorezuar Priljezen / Podato Received / Delivery	08.12	2021	1	viti god year
Organ / Shista Organ / Jednica Org / Unit	No Prct No Prct	Prct No Prct No	Sista Kolicina Quantity	
SKP-MJHC	5878/2021		1/3	



Republika e Kosovës
Republika Kosova – Republic of Kosovo

KËSHILLI I PAVARUR MBIKËQYRËS PËR SHËRBIMIN CIVIL TË KOSOVËS
NEZAVISNI NADZORNI ODBOR CIVILNE SLUŽBEKOSOVA
INDEPENDENT OVERSIGHT BOARD FOR THE CIVIL SERVICE OF KOSOVO

A.nr.919/2021

Këshilli i Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës-Kolegji për Shqyrtimin e Ankesave në përbërje nga: Malsore Gashi Bajraktari-kryetare, Eshref Shabani dhe Arben Mehmeti-anëtarë si dhe Valentina Kaçandolli Bekteshi-Zyrtare e Lartë për Bashkëpunim Profesional në cilësinë e procesmbajtëses, kanë shqyrtuar ankesën me numër A.nr.919/2021 të datës 10.11.2021 të parashtruar nga ankuesi me adresë Rruga “Veleshta”, pa nr., Prishtina e Re, Zona Perëndim, Komuna e Prishtinës, në çështjen juridike “kompensim material”, kundër organit të punësimit Policia e Kosovës, duke vepruar në pajtim me nenin 6 paragrafin 1 nën paragrafin 1.1 dhe nenin 18 paragrafin 1 nën paragrafin 1.7 të Ligjit Nr.06/L-048 për Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës dhe Rregulloren Nr. 02/2018 për Procedurën e Shqyrtimit dhe Vendosijes së Ankesave në Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës, në seancën për këshillim dhe votim të mbajtur me datën 08.12.2021, mori këtë

V E N D I M

HEDHET POSHTË si e jashtëafatshme ankesa me numër A.nr.919/2021 e datës 10.11.2021 e parashtruar nga ankuesi

A r s y e t i m

Ankuesi i punësuar në Policinë e Kosovës sipas Kontratës së punës me numër të referencës 07/1-01A/0168 të datës 22.11.2013 në vendin e punës “Zyrtar i Lartë Financiar” në Njësinë Sektori i Kontabilitetit/Drejtoria për Buxhet dhe Financa, me datë 28.05.2021 ankuesi parashtron kërkesën për kompensimin e një (1) page ekuivalente për vitin 2018, 2019 dhe 2020, krahasuar me pagën e rregullt mujore në fund vit, sipas Udhëzimit Administrativ Nr.02/2018 për Marrëdhënien e Punës në Policinë e Kosovës, Kapitulli VI Paga dhe Sistemimi i Personelit Policor, Neni 29 e Drejta në pagën dhe shpërblimet, pika 2 si dhe ti bëhet kompensimi i shtesës në pagë për kualifikim shkollor sipas pikës 3 si dhe pikës 3.1.

Me datë 10.06.2021 ankuesi merr përgjigje me numër të referencës 07/1-01SAP-P/5090 nga Drejtoria e Personelit, i cila i pa kënaqur me këtë përgjigje me datë 10.11.2021 me numër të protokollit 5381/2021 ka parashtruar ankesë në Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës me pretendim ankimor për kompensim material, duke u bazuar në Udhëzimin Administrativ Nr.02/2018 Mbi Marrëdhënien Punës në Policinë e Kosovës të nënshkruar me datë 14.11.2018 saktësisht neni 29 pika 1, 2, 3 dhe 5 parashel të drejtën e personelit të Policisë për shujtën ditore, të drejtën e personelit policor që të përfitojnë si shpërblim një pagë mujore ekuivalente me pagën e rregullt mujore në fund të vitit, shtesat për kualifikim shkollor-master, magjistër i shkencave 1% dhe Personeli Policor që është marrëdhënie të

vazhdueshme pune me Policin e Kosovës iu takon shpërblimi në vlerë prej 25% pagës mesatare në Policin e Kosovës pas çdo dhjetë (10) vite punë (paga jubilarë).

Këshilli i Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës, bazuar në Rregulloren Nr. 02/2018 për Procedurën e Shqyrtimit dhe Vendosjes së Ankesave në Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës më datë 17.11.2021 ka kërkuar përgjigje në ankesën e ankuesit nga Policia e Kosovës. Këshilli më datë 02.12.2021 ka pranuar përgjigjen në ankesë nga organi i punësimit me shkresat e bashkangjitura të lëndës faqe 1/12.

Kolegji për Shqyrtimin dhe Vendosjen e Ankesave, për vërtetimin e plotë dhe të drejtë të gjendjes faktike si dhe vendosjes në mënyrë meritore, ka administruar këto prova: Ankesa e ankuesit e datës 10.11.2021 e parashtruar në Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës; Përgjigja në kërkesë e datës 10.06.2021 me nr. i Referencës 07/1-01SAP-P/5090; Vërtetim punësimi i datës 26.05.2021; Formulari për vlerësimin e rezultateve në punë të nëpunësve civil dhe nëpunësve të shërbimeve publike për kategorinë drejtuese i mesëm, i ultë dhe profesionale i datës 28.01.2021; Kontratë pune për kohë të pacaktuar i datës 22.11.2013; Kopja e letër njoftimit e ankuesit; Formulari për vlerësimin e rezultateve në punë për vitin 2020 dhe 2019; Kartela e nëpunësit nga 2018 deri dhjetor 2020; Kërkesa e ankuesit e datës 28.05.2021; E-mail-at e datave 22.04.2021, 20.04.2021; Dëshmia nga libri i dorëzimeve të Policisë së Kosovës për praninë të përgjigjes së datës 10.06.2021 si dhe përgjigja në ankesë nga organi i punësimit me shkresat e bashkangjitura të lëndës.

Kolegji për shqyrtimin dhe vendosjen e ankesave, për vendosjen e kësaj çështje, pasi ka shqyrtuar të gjitha shkresat e lëndës të parashtruara nga palët, ka konstatuar se ankesa e ankuesit është e jashtëafatshme, sepse:

Kolegji për shqyrtimin dhe vendosjen e ankesave, nga provat e lëndës ka konstatuar se ankuesi Mentor Rexhepi me datë 28.05.2021 ka parashtruar kërkesë tek Drejtoria e Personelit e Policisë së Kosovës me pretendim ankimor për kompensimin e një (1) page ekuivalente për vitin 2018, 2019 dhe 2020, krahasuar me pagën e rregullt mujore në fund vit, sipas Udhëzimit Administrativ Nr.02/2018 për Marrëdhënien e Punës në Policinë e Kosovës, Kapitulli VI Paga dhe Sistemimi i Personelit Policor, Neni 29 e Drejta në pagën dhe shpërblimet, pika 2 si dhe ti bëhet kompensimi i shtesës në pagë për kualifikim shkollor sipas pikës 3 si dhe pikës 3.1.

Drejtoria e Personelit me datë 10.06.2021 me numër të referencës 07/1-01SAP-P/5090 i përgjigjet kërkesës së ankuesit të datës 28.05.2021 me të cilën e njofton se „REFUZOHET kërkesa e juaj e parashtruar me datës 28.05.2021, për pagesën e një pagë mujore (për tri vitet e fundit -2018, 2019 dhe 2020) në vlerën ekuivalente me pagën e rregullt mujore për muajin e fundit si dhe shtesa për kualifikim shkollor”.

Ankuesi i pa kënaqur me përgjigjen e Drejtorisë së Personelit me datë 10.11.2021 parashtron ankesë me numër të protokollit 5381/2021 në Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës me pretendim ankimor për kompensim material, duke u bazuar në Udhëzimin Administrativ Nr.02/2018 Mbi Marrëdhënien Punës në Policinë e Kosovës të nënshkruar me datë 14.11.2018 saktësisht neni 29 pika 1, 2, 3 dhe 5 parashih të drejtën e personelit të Policisë për shujtën ditore, të drejtën e personelit policor që të përfitojnë si shpërblim një pagë mujore ekuivalente me pagën e rregullt mujore në fund të vitit, shtesat për kualifikim shkollor-master, magjistër i shkencave 1% dhe Personeli Policor që është marrëdhënie të vazhdueshme pune me Policin e Kosovës iu takon shpërblimi në vlerë prej 25% pagës mesatare në Policin e Kosovës pas çdo dhjetë (10) vite punë (paga jubilarë).



Kolegji për Shqyrtimin e Ankesave, bazuar në nenin 24 paragrafi 3 të Ligjit Nr.06/L-114 për Zyrtarët Publikë, ka konstatuar se nëpunësi civil ka të drejtë të paraqesë ankesë drejtpërdrejt në Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil për çdo veprim apo mosveprim, që i cenon të drejtat apo interesat e ligjshme. të drejta këto, që burojnë nga marrëdhënia e Shërbimit Civil, ndërsa Ligji Nr.05/L-031 për Procedurën e Përgjithshme Administrative neni 127 përcakton se: **“1. Ankesa duhet të parashtrohet brenda tridhjetë (30) ditëve nga data kur pala është njoftuar për aktin administrativ; 3. „Nëse akti administrativ është lëshuar pa informacione, apo me informacion të pamjaftueshëm në lidhje me mjetet juridike (këshillën juridike), afati i parashkrimit nga paragrafi 1 i këtij neni është tre (3) muaj”.**

Kolegji për shqyrtimin e ankesave në bazë të dëshmimeve të ofruara ka konstatuar se ankuesi përgjigjen nga Drejtoria e Personelit të Policisë së Kosovës pa njoftim në lidhje me mjetet juridike (këshillën juridike) e ka pranuar me datën 14.06.2021 sipas librit dorëzimit të Policisë së Kosovës, ndërsa ankesën me numër protokolli 5381/2021 në Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës, e ka parashtruar me datën 10.11.2021, andaj Kolegji vlerëson se parashtrimi i ankesës nga ankuesi me datë 10.11.2021 në Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës, është jashtë afatit ligjor të përcaktuar me nenin 127 paragrafin 1 dhe 3 të Ligjit Nr.05/L-031 për Procedurën e Përgjithshme Administrative i cili përcakton se: **„Ankesa duhet të parashtrohet brenda tridhjetë (30) ditëve nga data kur pala është njoftuar për aktin administrativ” si dhe 3,, Nëse akti administrativ është lëshuar pa informacione, apo me informacion të pamjaftueshëm në lidhje me mjetet juridike (këshillën juridike), afati i parashkrimit nga paragrafi 1 i këtij neni është tre (3) muaj”.** Kolegji për shqyrtimin e ankesave, ka vlerësuar se ankuesi nuk e ka shfrytëzuar të drejtën e ankimit brenda afatit prej nëntëdhjetë (90) ditësh në Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës të Kosovës respektivisht nga data 14.06.2021 kur ankuesi e ka pranuar përgjigjen e datës 10.06.2021 me numër të referencës 07/1-01SAP-P/5090 të Drejtorisë së Personelit pa këshillë juridike.

Bazuar në këto rrethana, Kolegji për Shqyrtimin dhe Vendosjen e Ankesave, pas analizimit dhe vlerësimit të të gjitha shkresave të lëndës si dhe duke u bazuar në kompetencën e Këshillit dhe nenin 18 paragrafin 1 nën paragrafin 1.7 të Ligjit Nr.06/L-048 për Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës, vendosi si në dispozitiv të këtij Vendimi.

Këshillë juridike: Kundër vendimit të Këshillit, pala e pakënaqur e cila pretendon se vendimi i Këshillit nuk është i ligjshëm mund të iniciojë konflikt administrativ në gjykatën kompetente, brenda afatit prej tridhjetë (30) ditësh nga dita në të cilën i është dorëzuar vendimi. Inicimi i konfliktit administrativ nuk e ndalin ekzekutimin e këtij vendimi.

KËSHILLI I PAVARUR MBIKËQYRËS PËR SHËRBBIMIN CIVIL TË KOSOVËS

Lënda me numër A.nr.919/2021

Valentina Kaçanfolli Bekteshi

Zyrtare e Lartë për Bashkëpunim Profesional

Vendimi i dërgohet

- Ankuesit
- Drejtorit të Përgjithshëm të Policisë së Kosovës;
- Menaxheres së Personelit në Policinë e Kosovës dhe
- Arkivit të KPMSHCK-së.

Malsore GASHI BAJRAKTARI

Kryetare e Kolegjit

